



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Njoftim për Shtyp

06 Janar 2025

**Nga data 1 janar 2025, Shqipëria pranon Certifikatat e Qarkullimit EUR 1 të lëshuara në mënyrë elektronike nga vendet pjesëmarrëse në Konventë pan-Euro-Mediterriane**

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave njofton se nga data 1 janar 2025, **Shqipëria do të pranojë Certifikatat e Qarkullimit EUR-1 të lëshuara në mënyrë elektronike nga vendet pjesëmarrëse në Konventë pan-Euro-Mediterriane.**

Bazuar në njoftimin e publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (C/2024/7561 datë 30.12.2024), në lidhje me lëshimin elektronik të certifikatave të qarkullimit EUR.1, deri tani **vendet të cilat lëshojnë certifikata elektronike dhe që vendi ynë zbaton një marrëveshje të tregtisë së lirë janë:**

**Norvegjia:** Sistemi Norvegjez: Altinn - portali qeveritar për dialogun dixhital midis bizneseve, individëve privatë dhe agjencive publike. Data e fillimit: 02.04.2020. Link për verifikimin e origjinalitetit të certifikatave të qarkullimit: <https://eur1.toll.no>

**Turqia:** Sistemi Turk: MEDOS - " Sistemi i Automatizimit për Certifikatat e Origjinës dhe Certifikatat e Lëvizjes", Data e fillimit: 24 Prill 2018. Lidhja unike për çdo certifikatë lëvizjeje fillon me "https://mdc.gtb.gov.tr, "https://uygulama.gtb.gov.tr, "https://istanbul.ebirlik.net/" and/or "https://ankara.ebirlik.net/dolasim/app". (*aksesohet duke skanuar kodin QR në certifikatë*).

Ky njoftim i referohet:

*Ligjit 59/2024 datë 6 qershor 2024 (Fletore Zyrtare nr.113 datë 4 korrik 2024) "Për miratimin e vendimit nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale Pan-Euro-Mediterriane të Origjinës për ndryshimin e Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale pan-Euro-Mediterriane të Origjinës dhe të Rekomandimit nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale pan-Euro-Mediterriane të Origjinës" si dhe:*

*Vendimit 1/2024 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale, Vendi i cili lëshon certifikata të qarkullimit EUR.1 në mënyrë elektronike dhe data se kur ka filluar lëshimi i tyre, tregohet në njoftimin e publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria C.*